



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1341/ 2 prot,

Datë 30.05.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizim i Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Fedos*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-02672-04-25-2024, me objekt: “*LERJE PAJISJE FIZIOTERAPIE (SIPAS LISTES) PER DSHS-KURBIN*”, me fond limit 2.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Fedos*” SHPK me Nipt K01514009I dhe me adresë: *Rruga “Kujtim Laro”, Nr. Pasurisë 3/22, Kati. 2, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin.
Adresa: Lagjia Nr 4 Laç - Kurbin.

Në datën 29.05.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe autoritetit kontraktor është protokolluar ankesa me numër elektronik A/2024/4129, datë 29.05.2024, dhe me nr. 1341/2024 prot, datë 29.05.2024 e operatorit ekonomik “*Fedos*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-02672-04-25-2024, me objekt: “*LERJE PAJISJE FIZIOTERAPIE (SIPAS LISTES) PER DSHS-KURBIN*”, me fond limit 2.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “*Fedos*” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Fedos” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1341 prot, datë 29.05.2024.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Ne zbatim të ligjit nr 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në fuqi dhe VKM-se nr . 285, datë.19.12.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” , nga vleresimi i ofertës tuaj sipas kriterëve të DST –se . Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për mungesë sasive në të artikujve në dokumentacion për arsyen (et) e mëposhtme: 1- Shtojcen Nr.2 Listen e Çmimeve keni sjelle ofertën vetëm për 1 Tens . Ndersa Lista e çmimeve në DST është për 3 Tens. Pra në ofertën tuaj mungojnë 2 Tens. Duke ju falenderuar për pjesmarrjen tuaj.”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 30.05.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro